



KESHILLI I QARKUT DURRES

BUXHETI I VITIT

2016

I. Realizimi i Buxhetit te vitit 2015.

Në mbështetje të Ligjit Nr 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr 7776 dt. 22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal”, ndryshuar me Ligjin Nr 8399 dt. 09.09.1998, Ligjit nr.185/2013, “Per buxhetin e vitit 2014”, Udhëzimit Nr.2, dt.06.02.2012 të Ministrisë së Financave, “Per Procedurat Standarde te Zbatimit te Buxhetit”, Udhëzimit Plotesues Nr. 2, date 09.01.2015 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2015”si dhe të Vendimit të Këshillit të Qarkut me Nr. 1, dt. 31.01.2015 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2015”, prezantojmë realizimin e buxhetit të KQD për vitin 2015, duke marre per baze plan buxhetin e vitit 2015.

Detajimi i fondeve sipas programeve paraqitet sipas skemës së më poshtme.

Ia. Analiza e nivelit te te ardhurave Viti 2015.

Në tërësi, të ardhurat për vitin 2015 janë realizuar ne vlerë **20,931mije leke** nga **34.250 mije leke,te shprehura ne vlere 13.319 mije leke me pak**, ose të shprehura në % në masën **61%**.

Përbërësit e fondeve në funksion të realizimit të buxhetit janë:

- Fondet nga transferta e pakushtezuar **63.615 mije leke**
- Fondet nga të ardhurat e veta realizuar ne vitin 2015 **20,931 mije leke**
- Fondet nga të ardhurat te trasheguara nga viti 2014 **9.444 mije leke**

Performanca e institucionit të KQD vlerësohet mbështetur në realizimin e të ardhurave dhe përdorimit të tyre. Treguesit që lidhen me të ardhurat janë:

- a. Realizimi i të ardhurave sipas zerave
- b. Realizimi i të ardhurave nga kontributi i Komunave dhe Bashkive

a.Realizimi i të ardhurave sipas zërave paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr 1

000/ leke

	Permbajtja	Plani vjetor	Realiz 12/mujor	Diferenca ne 000/leke	Realizimi ne %
1	Nga lejet e ndertimit	0		0	
2.	Nga leje shfrytezimi	4500	57	4443	
3	Leje transporti	600	480	120	
4	Tarife sherbimesh	1,150	1,073	77	

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

5.	Kontributet	14,000	8.700	5300	
6.	Te tjera(donacione+ qera)	14,000	10.620	3.379	
	Totali te ardhurave	34.250	20,931	13.319	

Për një sqarim të detajuar të realizimit të të ardhurave në vazhdim prezantohet realizimi i tyre sipas zërave.

1a. Të ardhurat nga lejet e shfrytëzimit janë realizuar në vlerë absolute 251 mijë leke nga 1,480 mijë leke të parashikuara ose 1,229 mijë leke me pak.

Leje shfrytëzimi është dhënë për 4 subjekte.

2. Taksë për leje transporti

a. Në fushën e licensimeve të transportit rrugor.

Mbeshtetur në Ligjin Nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.15 datë 24.07.2007 të MPPTT të ndryshuar, nga sektori shërbimeve janë pranuar dhe shqyrtuar dokumentacionet për __ licensa dhe __ certifikata për “Transport malli për të tretë dhe me qira brenda vendit”, 1 liber udhëtimi dhe 2 dublikate të certifikatave.

Shuma e të ardhurave të siguruara për Keshillin e Qarkut është 480 mijë leke, realizuar në masën 80 %.

3. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve, ku përfshihen të ardhurat nga tarifat për shërbimet e Kadastrës dhe Urbanistikës, janë realizuar në masën 97.5% ose të shprehur në vlerë 77 mijë leke më pak se planifikimi.

4. Të ardhurat nga kontributi i komunave dhe bashkive, është realizuar në masën 62 %. Shpresojmë që përgjegjshmëria dhe mirëkuptimi nga bashkitë do të jetë në nivelin e duhur për të bërë pagesën e kontributit përkatës në masën dhe kohën e duhur.

Në vazhdim ju paraqesim tabelën ku pasqyrohen të ardhurat dhe masa në vlerë të realizimit të kontributit për çdo bashki.

Tabela Nr.2 (lekë)

Kontributet e Komunave dhe Bashkive për vitin 2015

000/ leke

NR REND	EMERTIMI	Plani për vitin 2015	Fakti për 12/m 2015
1	BASHKIA DURRES		8000
2	BASHKIA SHIJAK		200
3	BASHKIA KRUIJE		500
	TOTALI		8700

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

1.b.Analiza e realizimit të shpenzimeve sipas burimeve të të ardhurave

I. Përdorimi i transfertës së pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar (ose Granti) e akorduar për vitin 2015 ishte në vlerën **63.615 mije leke**.

Kjo Transfertë u përdor konform Vendimit të Këshillit Qarkut Durrës me Nr.1, datë 31.01.2015

Përdorimit i Transfertës së pakushtëzuar, për vitin 2015, paraqitet si me poshte:

Tabela Nr.3 (000 lekë)

Art	Emertimi	Plani 12/m 2015	Fakt 12/m 2015	Realizimi në %
	Perdorimi I fondeve nga Granti			
600	Paga ,shtesa	8506	8506	100
601	Sig.Shoq	4436	3927	
602	Keshilltare	6493	4797	
602	Shp.Operative	11478	6796	
604	Proj.IPA	500	0	
606	Shoqata Ryder	300	0	
605	Kuote Anetaresimi ne AER+AIE	600	156	
231	Investime	1416	416	
	Fonde per Aparatin	33759	24598	
	Fonde per Nd.Rrug nga granti	29856	29496	
	Totali i fondeve nga Granti	63615	54094	

Shpenzimet operative nga Granti jane si me poshte:

Tabela Nr.4 (lekë)

Shpenzimet operative nga Granti jane si me poshte: ne leke

GRUPI	LLOJI I SHPENZIMIT	PLAN Vjetor	FAKT Thesari
6020100	Kancelari	200000	113136
6020200	Materiale pune dhe pastrimi	70000	60560
6020300	Materiale per funks.e pajisje.zyres	362000	272916
6020900	Furniz.mat zyre e te pergjithshme	100000	
	shuma e grupit	732000	452912
6021007	Libra dhe publikime profesionale	100000	74144
6021010	Shpenz.per prodh.dok.specifik	100000	66500

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

	shuma e grupit	200000	140464
6022001	Konsum energji elektrike	900000	857270
6022002	Kons.uji	180000	334682
6022003	Shpenz.Telefonike e celulare	665000	502121
6022004	Posta dhe sherbim korieri	150000	56730
6022008	Sherb.te sigurise dhe ruajtje		
6022011	kosto trajnimi seminare	0	0
6022099	Sherbime te tjera interneti	245000	213600
6022099	Domein zyrtar I qarkut	5000	5000
6022099	E/mail	0	0
	shuma e grupit	2145000	1540701
6023100	Karburant dhe vajra	950000	436319
6023200	Pjese kembimi	774000	645408
6023300	Siguracion mj.transporti	314000	125063
	shuma e grupit	2038000	1207330
6024100	Udhetime e djeta brenda vendit	30000	28640
6024200	Udhetim e djeta jashte vendit	2278000	1346830
	Shuma e grupit	2318000	1375470
6025300	Shpenz.per miremb.ndert.lyerje	400000	0
6025500	Shpenz.miremb.ashensori	400000	0
6025500	Shpenzime miremb.paj,.teknike	100000	12000
	shuma e grupit	900000	12000
6029001	Kosto trajnimi seminare	100000	28820
6029001	Shpenzime per pritje percjellje	50000	0
6029002	Aktivitete kulturore	200000	26400
6029002	Panaire	100000	90000
6029003	Shpenzime gjyqesore	95000	7200
6029003	Shpenzime zbat.vendime gjyqesore	2200000	1717445
6029006	Pagesa komisione	100000	80000
6029006	Pagesa per sherbime teknike	300000	116712
	shuma e grupit	3145000	2066577
	Totali I shp. Operative per Aparatin	11478000	6795634

Perdorimi i fondeve nga Granti per Ndermarjen e Rrugeve Rurale paraqitet si me poshte:

Tabela Nr.5 (000 lekë)

Art	Emertimi	Plani 12/m 2015	Fakt 12/m 2015	Realizi mi në %
-----	----------	-----------------------	-------------------	-----------------------

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

	Fonde per Nd.Rrug nga granti	29856000	29495607	
	Nga keto:			
	Paga	12000000	12000000	
	Sig.Shoq	2543000	2455727	
	Shpenzime operative nga keto	14872000	14872000	
	Shpenzime per aparatin	5402000	5402000	
	Shpenzime per mirembajtje, blerje asfalt, cakell etj	9470000	9470000	
	Investime	441000	167880	

Transferta e pakushtezuar per vitin 2015 u realizua në vleren **54.094 mijë lekë ose 85%**. Vlerat e transfertës së pakushtëzuar për QKD në vitet 2007 - 2015 paraqitet si më poshtë:

- viti 2007 në vlerë 44.253 mijë lekë
- viti 2008 në vlerë 60.257 mijë lekë
- viti 2009 në vlerë 62.115 mijë lekë
- viti 2010 në vlerë 54.802 mijë lekë
- viti 2011 në vlerë 53.881 mijë lekë
- viti 2012 në vlerë 58.745 mijë lekë
- viti 2013 ne vlere 60.972 mije leke
- viti 2014 ne vlere 67.096 mije leke
- viti 2015 ne vlere 63.615 mije leke
- viti 2016 ne vlere 28.470 mije leke

II.Përdorimi i fondeve nga të Ardhurat për Keshillin e Qarkut Durres dhe Ndërmarrjen e Rrugëve

Perdorimi I fondeve nga te **Ardhurat** per Keshillin e Qarkut dhe Nd.Rrugeve

	Emertimi	pl. Vjetor 2015	pl.celur 2015	Fakti 2015	dif cel.fakt	Pa realiz Proc.	Pa likujduar
600	Paga Aparati I K. Qarkut	18058	13832	13792			
	Sig.Shoq	0	0	0	0		
	Paga pers.ristrukturimit	2586	0	0			
	shpenzime personeli	20644	13832	13792			
	Keshilltare	1515	0	0	0		
	Shpenzime operative ,	2673	400	400	0		
	Mb.financiare projekte IPA	500	0	0	0		
	Financim I shoqates Ryder	300	0	0	0		
	Shoqata e te verberve+romet	70	70	70	0		
	Fondi i kontigjences	1000	0	0	0		
	Fondi Rezerve	900	0	0	0		
	INVESTIME DHE STUDIME	4098	0	0	0		

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

Masterplani lok.K.Bubq		0	0	0	1079
Rik.rugeve fsh. gjepalaj	1256	1256	1256	0	
Supervizion e kolaudime	184	184	184	0	
Rik. Lapidare e simbole lufte	55	55	55	0	
Blerje.paj.zyre	200	0	0		
Pajisj.per disipl.e parkimit	200	0	0		
blerje paisje kompjuterike	384	384	384	0	
Totali I fondeve per aparatin	29781	16250	16210		
Totali I fondeve Nd.Rrug.	13913	8892	8597		
Paga aparati	3230	2920	2641	0	
investime	1060	0	0		
Shpenzime op. ad , nga keto:	9623	5972	5956	0	
Per aparatin	3352				
Blerje asfalt, emuls. etj	6271				
Blerje sinjalistike etj	1060	0	0		
Totali I buxhetit nga te ardhurat	43694	25142	24806		

Perdorimi i Fondeve nga Grantet Konkruese

Emertimi i objekteve	Financim v.2012	Likujdime v.2012	Vlera fituse	Financim 2013	Likujdime v.2013	Financim 2014	Likujdime v.2014	Likujdime v.2015	Diferenca Pa likujduar
Rik.rruga Mansk	2,692,269	0	35,534,894	19,098,497	12,604,932	0	9,185,834	0	13,744,128
Rik.rrug.T.Rrashb	1,471,341	1,470,000	24,557,450	13,154,785	13,154,785	9,931,324	7,648,842	2280949	0
Rik.rrug. Kenetes	50,000,000	0	33,745,313	0	33,707,640	0	0		0
Totali	54,163,610	1,470,000	93,837,657	32,253,282	59,467,357	9,931,324	16,834,676	2280949	13744128

Sa me lart pasqyrohet perdorimi i Fondeve nga Grantet Konkruese(te ardhura nga Fondi i Zhvillimit Rajoneve)

2. ANALIZA E BUXHETIT DHE PERFORMANCES SIPAS PROGRAMEVE

2a. Realizimi i Shpenzimeve të vitit 2015 sipas programeve

Programimi i shpenzimeve të përgjithshme sipas funksioneve të Këshillit të Qarkut për vitin 2015 ishte në vlerën **82.190,000** lekë.

Karakteristikat kryesore të shpenzimeve të programuara për vitin 2015 përcaktuan:

- Rritjen me përparësi të shpenzimeve në sektorët prioritarë si në Infrastrukturë (Ndërmarrja e Rrugëve Rurale), shërbimi për kujdesin social dhe programi për kulturën dhe turizmin.
- Zbatimin e procedurave të reja të buxhetimit të fokusuara tek produkti/rezultati, për çdo program.
- Ruajtjen të pandryshueshme të nivelit të shpenzimeve administrative në bazë të normimit të tyre.

*)Në programin e Administratës vendore është përfshirë edhe fondi Rezervë e ai i Kontigjencës.

*)Ne programin e Infrastruktues rrugore nuk është përfshirë shuma prej 1,739 mije leke për blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve të cilat janë realizuar,por mbetur pa likuiduar për mungesë fondesh.

Ky programim u mbështet në politikat sektoriale dhe prezanton aktivitetet e të gjitha Njësive Shpenzuese për vitin 2014, me qëllim arritjen e objektivave dhe realizimin e produkteve të pritshme sipas kostove përkatëse. Programet sipas funksioneve dhe sektorëve prioritarë në Keshillin e Qarkut, të planifikuara për vitin 2014, prezantohen në vijim:

1. Programi i Infrastruktues Rrugore	37,132	mije leke
2. Programi i Shërbimit të Kujdesit Social	500	mije leke
3. Programi i Kulturës dhe Turizmit	1,400	mije leke
4. Program i Administratës Vendore	71,544	mije leke

1. PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE

Në Keshillin e Qarkut Durres, Strukturat përgjegjëse për realizimin e këtij Programi janë:

- Ndërmarrja e Rrugëve Rurale Rajonale në varësi të KQD
- Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve në Qark

Qëllimi i Programit

Ndërmarrja e Rrugëve Rurale ka si objekt të saj administrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor rural të rrethëve Durrës dhe Krujë, mbajtjen në gatishmëri të rrjetit rrugor rural, riparimin rutinë në shtresat rrugore si dhe pastrimin e kanaleve anësore dhe veprave të artit.

Ky program u planifikua të financohej me shumën **37,132,000** lekë.
Ku vetëm për Ndermarjen e Rrugëve Rurale **31,984,000** leke.

Objektivat e programit

- Sigurimi i një qarkullimi të shpejtë , komod e të sigurtë
- Sigurimi i rritjes së kapaciteteve transportuese
- Përmirësimi i infrastrukturës ndihmëse të transportit publik.

Buxheti i Nd.Rrugëve Rurale për vitin 2015

Në 000/ lekë

Artikull	Emertimi i shpenzimit	Plani 2015	Fakti 2014	Real. në %
600	Paga e shtesa	14920	14641	

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

601	Sig.Shoq	2543	2455	
	Shpenzime personeli	17463	17096	
602	Shpenz.operative dhe mirëmbajtjeje	20844	20828	
	Nga këto:			
	Shpenzime op. për administratën	6720	6278	
	Shpenzime mirembajtje	14124	14549	
231	Blerje sinjalistike	441	168	
	Shuma	38748	38092	

Vlen te theksohet se detyrat e caktuara per kete Ndermarje me buxhetin e vitit 2015 jane realizuar plotesisht, duke likujtuar edhe detyrimet e vitit 2013 ndaj kontraktoreve per objektin :

- _ « Blerje Asphalt dhe Emulson » per 12.328 mije leke
- _ « Blerje Cakull dhe transport »per 2.220 mijeleke

Për vitin 2015 është punuar me mirëmbajtjen e segmentev rrugoretë cilat janë nën varësi të ndërmarjes sonë në perjudha kohore të përcaktuara nga tenderimi i materialeve s asphalt-obeton, cakull dhe stabilizant.

Këto ndërhyrje janë kryer në muajin Korrik- Nentor 2015

Nga Fondi i zhvillimit te Rajoneve per Grantet konkurruese Keshillit te Qarkut Durresi jane akorduar fonde per objektin

1. Rikonstruksioni i rruges tuneli i Rrashbullit – Varrezat e reja.
2. Rikonstruksioni i rruges nacionale Qender- Maskuri.
3. Rikonstruksioni i rrugeve te kenetes (Bisht Kamza).

Per te tre objektet kane perfunduar punimet konform projekteve dhe preventivave perkatese (me ndryshimet) ku per objektin « Rikonstruksioni i rrugeve te kenetes (Bisht Kamza), Bashkia Durres,eshte kryer marrja perfundimtare ne dorezim te objektit dhe transferimi perkates.Per transferimin e e objekteve te perfunduar duhen shlyer detyrimet kundrejt supervizore e kolaudatore Te cilat jane likujtuar me fondet e keshillit te qarkut gjate vitit 2015 per 600 mije leke dhe mbeten per tu parashikuar ne buxhetin e viit 2016 dhe 450 mije leke.

Gjete vitit eshte ndjekur ne vazhdimesi akordimi i pjeses se mbetur te financimit te d y objekteve ku ne fund te vitit u sigurua financimi per objektin “Rikonstruksioni i rruges tuneli i Rrashbullit – Varrezat e reja”, dhe u likujdua, dhe mbetet per tu financuar per vitin ne vazhdim objekti “ Rikonstruksioni i rruges nacionale Qender-Maskuri.

II.PROGRAMI I SHERBIMIT TE KUJDESIT SOCIAL

Programi i kujdesit social parashikon hartimin e programeve te kujdesit social ne nivel qarku per te gjitha shtresat dhe grupet ne nevoje.

Qellimi:

Mbulimi i nevojave ekonomike dhe sociale te grupeve ne nevoje ne Qarkun e Durrës, duke siguruar i nje mjedis favorizues per te siguruar mbijetesën dhe zhvillimin maksimal te individëve, ne aspektin e zhvillimit fizik, mendor, shpirtëror, moral, psikologjik dhe social, ne perputhje me dinjitetin njerëzor. Shërbimet shoqërore do te kontribuojne per ruajtjen e pozitës se individëve ne shoqëri dhe per t'i mbrojtur ata nga perjashtimi social.

Objektivat :

- a. Sigurimin e mbulimit te nevojave ekonomike dhe sociale te familjeve dhe individëve ne nevoje ne Qarkut te Durrës, duke i ri-integruar perfituesit ne ambientin shoqëror, duke i harmonizuar programet e mbrojtjes dhe te zhvillimit social dhe duke i transformuar ne nje instrument aktiv te zhvillimit shoqëror,
- b. Vazhdimi i mbështetjes financiare te Shoqates se te Verberve Durrës dhe Shoqates se te verberve Kruje, e cila ofroji gjate vitit 2013, shërbime te integruara per kete grup social, duke permbushur nevojat sociale te ketij grupi.
- c. Nxitjen e bashkeveprimit ndermjet organeve lokale te nivelit te pare per permiresimin e shërbimeve sociale sipas standarteve bashkëkohore.

Ne zbatim te politikave te Keshillit Qarkut Durrës, per te bere te mundur ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbështetje financiare ne Keshillin e Qarkut funksionojne:

1. Komitetit Drejtues Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Qark.
2. Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Qark.

Bazuar ne Ligjin Nr.10347, dt.04.11.2010 “Per mbrojtjen e te drejtave se Femijes”, Keshilli i Qarkut Durrës ka ngritur Njesine per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve per Qarkun Durrës. Njesia eshte njohur dhe informuar mbi bazen ligjore per ngritjen dhe funksionimin e saj dhe ka vendosur marredhenie institucionale me Agjensine Shtetërore per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve prane Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, e cila raportohet periodikisht ne rruge zyrtare nga Njesia per aktivitetet e saj ne perputhje aktet nenligjore perkatese.

Aktualisht Keshilli Qarkut Durrës ka hedhur urat e bashkepunimit me UNICEF-in me qellim ngritjen dhe funksionimin e Njesise. Ne kuader te ketij bashkepunimi Keshilli Qarkut Durrës po harton nje projekt te perbashket me UNICEF ne perputhje me nevojat specifike per qarkun Durrës dhe eshte ne prag te nenshkrimit te nje Memorandum Bashkepunimi ndermjet tyre. Unicef do te ofroje mbështetje financiare, asistence teknike dhe ekspertize per zbatimin e ketij projekti te perbashket.

- Komunikim i vazhdueshëm me aktorët dhe institucionet publike rajonale për mbledhjen e të dhënave.
- Komunikim i vazhdueshëm me Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pranë Ministrisë së Mirëqeniës Sociale dhe Rinisë.
- Nxit procesin e ngritjeve së NJMF-ve në Bashki dhe Komuna, proces i cili ka përfunduar me sukses me ngritjen e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve për të gjitha komunat dhe bashkitë e qarkut Durrës.

- Identifikimin e organizatave të ndryshme lokale që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë, me qëllim shfrytëzimin e burimeve lokale për të siguruar një akses sa më të madh.
- Komunikim i vazhdueshëm me organizatën lokale Terre Des Hommes dhe Oe cila po shërben si mbështetëse në procesin e ngritjes së NJMF-ve në bashki/komuna, dhe fuqizim kapacitetesh pranë këtyre strukturave.
- Eshtë realizuar Marrëveshja Bashkëpunimit ndërmjet organizatës lokale Terre Des Hommes dhe Këshillit të Qarkut Durrës, për inicimin e një fushate trajnimi 12 ditore të specialistëve të NJMF-ve të Bashkive/Komunave të qarkut. Në kuadër të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, në një fazë të mëvonëshme është menduar të mbështetet me logjistikën e nevojshme ngritja e një NJMF në një ose dy nga njësitë vendore të nivelit të parë, sipas vlerësimit të nevojave të kryera nga Këshilli i Qarkut.

3. Komiteti Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve Komunitare në Qark

Ka funksionuar organizimi dhe mbledhja e Komitetit të Vlerësimit të Nevojave për Qarkun Durrës, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta dhe UNDP, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Romët dhe Plan Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2010 -2015". Gjatë këtij viti, ky Komitet u mblodh në takim e radhës ku u analizuan dhe u evidentuan gjendja dhe problemet e komunitetit rom në Qarkun Durrës, në mënyrë që të elimonohen sa më shumë ne të ardhmen për të bërë të mundur integrimin e plotë të këtij komuniteti në jetën social ekonomike të Qarkut.

4. Grupi Teknik për Çështjet Rome në Qark

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom, Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen e Dekadës Rome dhe Udhezimeve të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, Këshilli i Qarkut Durrës me anë të Urdhrit të Brendshëm Nr.97, dt.27.12.2011, ka ngritur Grupin Teknik për Çështjet Rome për Qarkun Durrës.

GTCR ka për qëllim evidentimin në kohë reale të situatës social-ekonomike, vlerësimin sasior dhe cilësor të nevojave të komunitetit Rom, grumbullimin dhe koordinimin e të dhënave statistikore të siguruar në rrugë zyrtare dhe jo zyrtare, për të përcaktuar shkallën e vulnerabilitetit dhe përjashtimit social që përjeton komuniteti Rom, shfrytëzimin e burimeve lokale për të siguruar një akses më të madh të këtij komuniteti për shërbimet që ofrohen në nivel qarku

- Në bashkëpunim me UNDP, Këshilli i Qarkut Durrës, ka nënshkruar një Akt-Marrëveshje Bashkëpunimi në kuadër të Programit të përbashkët "Fuqizimi i Komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri", me qëllim përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Romët dhe Plan Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2010 -2015" duke monitoruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare, dhe ofruar ndihmë për forcim kapacitetesh lokale në mbështetje të Komunitetit Rom në nivel lokal.

- Grumbullimin dhe koordinimin i të dhënave statistikore sipas fushave prioritare të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit “Për Dekadën e Përfshirjes së Komunitetit Rom” të siguruara në rrugë zyrtare dhe jo zyrtare.
- Mbledhje periodike të të dhënave nga njësitë vendore, sipas indikatorëve të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom.
- Hedhjen e tyre në sistem web-based online, trajnuar nga PNUD dhe MPÇSSHB, dhe pajisur me User name dhe Passëord për të loguar në këtë program web-based, me qëllim raportimin periodik në kuadër të monitorimit të Strategjisë Kombëtare.
- Bashkëpunim me UNDP, për funksionimin e GTÇR duke ofruar ndihmë për forcim kapacitetesh lokale në mbështetje të Komunitetit Rom në nivel lokal.

Mbështetje shoqatave

Koordinimi, mbledhja e dokumentacionit, orientimi dhe hartimi i Akt-Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Qarkut dhe organizatave të ndryshme, projekt-propozimet e të cilave janë bashkë financuar nga Këshilli i Qarkut si më poshtë vijon:

- ***Shoqata e të Verbërve Durrës / Krujë***

Mbështetur në V.K.M. nr. 549, dt.07.11.2002 për një ndryshim në V.K.M. nr. 277, dt. 18.06.1997 “ Për përfitimin nga Statuti I të Verbërve ” , Këshilli I Qarkut Durrës prej vitesh ofron mbështetje financiare sipas një marrëveshjeje të nënshkruar ndërmjet dy palëve, Shoqatës së të Verbërve Durrës dhe Krujë, në mbështetje të projektit të zbatuar nga këto dy shoqata. Per vitin 2015 kjo shoqate eshte mbeshtetur me 50.000 lek.

Projekti ka për qëllim:

1. Përmirësimin e jetës së të verbërve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne për eliminimin gradual të barrierave informuese të personave të verbër dhe,
2. Sigurimin e mbështetjes dhe përfshirjen e te verbërve në veprimtaritë kulturore sportive dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së tyre në veprimtari rajonale dhe kombëtare.

- ***Shoqata Ryder, Dega Durrës***

Bazuar në VKM nr. 563, dt.12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, Këshilli i Qarkut Durrës mbështet financiarisht Projektin me titull “Ndihmë të sëmurëve me kancer, për përmirësimin e cilesisë së jetës në fazën terminale ”të shoqatës “Ryder Albania” , Durrës.

Fondacioni Ryder Albania vepron prej disa vitesh në Shqipëri në qytetin e Tiranës dhe të Durrësit. Projekti “ Ndihmë të sëmurëve me kancer, për përmirësimin e cilesisë së jetës në fazën terminale” synon rritjen e cilësisë së jetës, kontrollit të dhimbjes për të sëmurët në fazën e fundit të sëmundjes dhe jetës së tyre, duke ofruar shërbime mjekësore, suport psiko – social për të sëmurët dhe familjaret e tyre . Ne vitin 2015 ky fondacion eshte planifikuar te mbeshtetej financiarisht me 500 mijeleke, por qe nuk u realizua

- ***Shoqata Rome***

Bazuar ne VKM nr. 563, dt.12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore” dhe në mbështetje të Planit Kombëtar të Veprimit, konkretisht fushës së gjashtë prioritare Trashëgimia Kulturore, me qëllim strategjik: *Ruajtja dhe Zhvillimi i Trashëgimisë Kulturore të Minoritetit Rome si një Element i Integruar në Trashëgiminë Kulturore Kombëtare dhe, Nxitja e Respektit të të Rinjve ndaj Diversitetit Kulturor*, Këshilli i Qarkut Durrës për vitin 2015, rej 20 mije leke parashikoi në buxhetin e tij, një shumë simbolike në mbështetje të projekt propozimeve nga organizata rome, që parashikojnë aktivitete në shërbim të komunitetit rom.

Lidhur me drejtimin e dyte, per mbledhjen e informacionit dhe mbajtjen lidhje me institucionet dhe organizatat qe veprojne ne Qarkun e Durresit, si edhe me Ministrite, jane mbajtur lidhje me:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit:

- Ky pyetsor eshte pregatitur per tu perdorur nga konsulenti gjate vizitave pilot ne terren ne zonat rurale te 9 Qarqeve qe jane subjekt i ketij studimi per fazen e 3 te programit te furnizimit me uje te zonave rurale – RWS. Ai sherben per te mbledhur te dhena per kushtet aktuale te sistemeve te furnizimit me uje neper fshatra. Te dhenat e grumbulluara do te sherbejne si baze per nxjerrjen e konkluzioneve te studimit.

UNDP (PMUD)

Keshilli Qarkut Durres ne bashkepunim me UNDP ka nenshkruar nje Akt-Marreveshje ne kuader te Programit te perbashket "Fuqizimi i Komuniteteve lokale ne nevoje ne Shqiperi", me qellim permbushjen e objektivave te Strategjise Kombetare per Romet dhe Plan Veprimit te "Dekades se Perfshirjes se Romeve 2010 -2015" duke monitoruar zbatimin e Strategjise Kombetare, dhe ofruar ndihme per forcim kapacitetesh lokale ne mbeshtetje te Komunitetit Rom ne nivel lokal duke ofruar mbeshtetje dhe asistence teknike dhe ekspertize nga UNDP per ngritjen dhe funksionimin e Grupit Teknik.

Aktualisht Keshilli i Qarkut Durres po mbledh informacionin per indikatorët per ceshtje rome nga njesite vendore te nivelit te pare per plotesimin e Udhezuesit per Indikatorë qe mblidhen nga zyrtare ne Keshillat e Qarqeve dhe se shpejti do te beje pasqyrimin e tyre ne sistem online duke siguruar nje panorame te pergjitheshme per sherbimet e ofruara per komunitetin rom dhe aksesin ndaj tyre ne nivel qarku. Ne te njejten kohe nuk eshte komunikuar vetem me njesite vendore, por edhe me te gjitha Drejtorite Rajonale te qarkut Durres, me konkretisht me perfaqesuesit e tyre te cilet jane antare te Grupit Teknik per Ceshtjet Rome prane Qarkut Durres. Antaret jane informuar mbi listen e indikatorëve dhe jane angazhuar ne plotesimin e tyre sipas te dhenave qe disponojne per komunitetin Rom sipas Drejtorive Rajonale perkatese duke i dorezuar keto te dhena prane Keshillit te Qarkut Durres. Se shpejti te gjithë antaret e Grupit Teknik per Ceshtjet Rome do te perfshihen ne nje faze te dyte trajnimi mbi menyren e grumbullimit te ketyre te dhenave dhe hedhjes se tyre ne sistem online.

Ministrite e Linjes:

Gjate vitit 2015 eshte punuar edhe ne drejtim te mbledhjes dhe ofrimit te informacionit ndaj Ministrive te Linjes si korrespondenca e mbajtur me Ministrine e Brendeshme lidhur me rritjen e aftesive te bashkepunimit te njesive vendore, apo me Ministrine e Puneve Publike lidhur me sasite e mbetjeve te ngurta dhe inerte, vend depozitimet e tyre, etj. Gjithashu eshte punuar me Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

- Perfaqesues te Keshillit te Qarkut, te cilet jane edhe antare te Grupit Teknik, jane trajnuar nga Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta ne bashkepunim me UNDP dhe ITAP mbi Udhesuesin per Monitorimin dhe Raportimin e Progresit te Indikatoreve te Planit Kombetar te Veprimit per Dekaden e Perfshirjes se Romeve 2010-2015 dhe kompjuterizimin e mbledhjes se te dhenave ne nivel rajonal.

Kjo konsiston ne krijimin e nje sistemi “web-base” te monitorimit dhe raportimit te Planit te Veprimit i cili do te perdoret nga Sekretariati Teknik prane MPCSSHB per te gjeneruar raporte vjetore te Planit te Veprimit te Dekades Rome.

- Raportimi i sasive te mbetjeve urbane dhe inerte sipas komunave dhe bashkive ne Qark Prane Ministrine e Puneve Publike dhe Transportin.

Ne kete kuader eshte punuar edhe ne drejtim te plotesimit te pyetesoreve te ndryshem te ardhur nga ministrite e linjes apo organizata te ndryshme si Fondi Shqiptar i Zhvillimit, apo pyetesori per studim i Bankes Gjermane per Zhvillim per te mbuluar me sistemin e ujesjellesit edhe komunitat dhe fshatrat e pa mbuluar deri me sot ne Qarkun Durres.

Realizimi i ketij program u bë në masën 90 %. Ishin planifikuar 570 mijë/lekë e u realizuan 450 mijë/lekë, kjo e ndare si me poshte:

- Financim Shoqata e te verberve Durres, Kruje 50 mije leke
- Financim I Shoqates Romeve 20 mije leke
- Finmancim I shoqates ryder ---- mije leke

III.PROGRAMI I KULTURES DHE TURIZMIT

Qarku i Durresit perfshihet ne zonen prioritare per zhvillimin e turizmit dhe njekohesisht eshte nje nga portat me te rendesishme te Shqiperise drejt Europes. Programi i sektorit te Turizmit do te synoje te ndikoje sa me pozitivisht ne zhvillimin e turizmit dhe ne krijimin e lidhjeve te reja me partnere dhe institucione kombetare dhe nderkombetare duke tentuar ti jape nje shtyese te re iniciativave dhe bashkepunimit ne projekte te ndryshme , të cilat janë kthyer tashmë në një traditë për Keshillin e Qarkut .

Ky program tenton të promovojë vlerat turistike dhe kulturore te pamohueshme te ketij rajoni.

Politika e Programit:

Politikat e ketij programi synojne nje promovim sa me te frytshem dhe te sukseseshem te vlerave kulurore dhe te mundesive turistike qe paraqet qarku i Durresit, e arritur kjo ne nje bashkepunim sa me te plote me bashkite dhe komunitat e qarkut si dhe me perthithjen nga partneret tane nderkombetare te praktikave me te mira europiane ne keto fushe.

Objektivi 1.

Mbrojtjen, forcimin dhe shpalosjen e identitetit të qarkut në drejtim të vlerave kulturore dhe resurseve turistike.

Objektivi 2.

Nxitjen dhe promovimin per nje turizem te integruar ,terheqes dhe te shitshem .

Objektivi3.

Bashkepunim me organizma kombetare dhe nderkomebtare lidhur me hartimin e projekteve ne kete fushe

Objetivi 4

Grumbullim dhe përpunimit të të dhënave turistike ne nivel rajonal pasi planifikimi i turizmit pa këto të dhëna bëhet i pamundur

Objektivi 5

Koordinim me institucione te qeverisjes qendrore dhe vendore per nje akses me te madh te komuniteteve provinciale e rurale në panaiet dhe aktivitetet promovuese mbi turizmin duke rritur keshtu dukshmërinë dhe duke bere te mundur zhvillimin e turizmit në keto zona gje qe sjell zhvillim ekonomik te zones.

Produktet e realizuara gjate vitit 2015:

Sektori i Turizmit ne Drejtorine e Politikave te Zhvillimit te Qarkut Durres me qellimin e realizimit te objektivave per vitin 2014 dhe ne perputhje me strukturen organizative te KQD si edhe ne funksion te kerkesave qe parashtrohen nga Komiteti i Turizmit ka realizuar keto veprimtari sipas fushave perkatese:

- Pjesëmarrje në panaiet dhe ekspozita, konferenca shkencore, brenda dhe jashte vendit për promovimin e turizmit,
- Pjesëmarrja ne aktivitetet e AER per promovimin e turizmit dhe qarkut Durres ne arenen nderkombetare,
- Pjesëmarrja dhe organizimi i workshopeve dhe trainimeve ne fushen e turizmit (ne bashkepunim me sektorin e Projekteve),
- Publikimi i materialeve promovuese per turizmin.
- Identifikimi dhe promovimi i te gjitha monumenteve te kultures
- Identifikimi dhe regjistrimi i te gjithë operatoreve dhe njesive qe veprojne ne sektorin e Turizmit
- Organizimi dhe grumbullimi i te dhenave te sakta statistikore me qellim njohjen e gjendjes dhe hartimin e politikave te sakta rajonale
- bashkepunimi efektiv nepermjet operatoreve publike dhe private sidomos ne drejtim te hartimit te paketave turistike me qellim rritjen e diteqendrimeve te turisteve e vizitoreve ne qarkun e Durresit.
- Hartimi i pyetesoreve per turizmin per te percaktuar tendencen e zhvillimit te turizmit ne qarkun e Durresit
- Pergatitja e studimeve, kerkimeve dhe artikujve shkencore per turizmin ne funksion te nxitjes se turizmit ne Qarkun e Durresit
- **Pjesëmarrja ne Panaiet, konferenca shkencore dhe ekspozita per promovimin e turizmit ne qarkun Durres brenda dhe jashte vendit**

Pjesëmarrja ne panaiet dhe ekspozita ne kuadrin e organizmave lokale, kombetare dhe rajonale eshte nje nga objektivat kryesore te punes ne qarkun e Durresit ne fushen e turizmit pasi kjo ndihmon ne realizimin e nje marketingu te pershatateshem ne fushen e turizmit. Ne kete kuader gjate 2015 Qarku i Durresit ka marre pjese vazhdimisht ne panaiet dhe konferencat shkencore e organizuara nga MTKRS.

Nje paraqitje kjo mjaft e mire ku Sektori i Turizmit te Keshillit te Qarkut Durres prezanton vlerat e rralla dhe origjinale te Qarkut Durres si nje rajon ne zbulim me vlera te medha

turistike dhe kulturore. Pjesemarrja ne panairë kombëtare dhe nderkombëtare pervec promovimit te turizmit krijon per qarkun Durres edhe mundesi te reja bashkepunimi.

- **Pjesemarrja ne Aktivitetet e AER**

Anetaresimi ne AER dhe pagesa e kuotizacionit te pervitshem ne AER na mundeson perdorimin e nje sere instrumentesh per te mbeshtetur turizmin dhe nxitur iniciativen dhe perfitimet nga fondet strukturale ne fushen e turizmit. AER kontribuon ne permiresimin e koordinimit per te promovuar turizmin e qendrueshem.

- **Pjesemarrja dhe organizimi i workshopeve dhe trainimeve ne fushen e turizmit,** Zhvillimi i turizmit vecanerisht zhvillimi i qendrueshem i turizmit eshte objektivi kryesor per turizmin ne qarkun Durres. Pikerisht per te realizuar kete komponent sherben edhe organizimi i trainimeve dhe pjesemarrja ne workshope qe i sherben shkembimit te eksperiencave dhe perfitimit nga “best practice” ne nivel kombëtar dhe nderkombëtar.

• **Identifikimi dhe promovimi i te gjitha monumenteve te kultures**

Sektori i Turizmit ne Qarkun e Durresit ka nje baze mjaft te mire te dhenash per monumentet kulturore dhe natyrore te qarkut te Durresit i cili eshte pasuruar me tej gjate 2015.

Nje promovim i mire i vlerave kulturore eshte bere dhe nepermjet publikimit te materialeve per monumentet kulturore dhe natyrore te qarkut te Durresit ne website te Projektit STAR dhe ne website te KQD te kryer gjate te gjithë vitit 2015.

Ne vazhdim gjate te gjithë vitit 2015 eshte bere nje mbledhje e metejeshme e materialeve per te pasuruar bazen e te dhenave per monumentet e kultures qe ndodhen ne qarkun e Durresit dhe jane botuar ne faqe gazete ne formen e suplementit me materiale per pasurite kulturore dhe natyrore te Qarkut te Durresit.

Marrëdhëniet me institucionet dhe shoqatat ndërkombëtare

Këshilli i Qarkut Durrës është antar e :

- Asamblesë të Rajoneve Evropiane (AER)
- ADRIGOV

Ne fushen e emergjencave civile.

Ne zbatim te ligjit Nr.8756 date 26.03.2001 “Per emergjencat civile dhe ne mbeshtetje dhe zbatim te V.K.M. nr.206 date 26.03.1998 “Per pjesemarrjen e shtetit ne perballimin ne raste fatkeqesish” ndryshuar, si dhe te V.K.M. nr.329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenijes se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, jane ndjekur me korrektese rastet e emergjencave civile te ndodhura dhe te ardhura ne Keshillin e Qarkut nga bashkite dhe komunat, duke bere verifikimet dhe vleresimet perkatese te demeve te shkaktuara duke percjelle praktikat prane tyre per vazhdimin e procedurave.

Konkretisht nga ana e jone jane shqyrtuar te gjithë rastet si ato qe kane qene objekt i V.K.M. nr.206, date 26.03.1998, te V.K.M. nr.329 date 16.05.2012 dhe ashtu dhe rasteve te paparashikuara duke dhene pergjigje ne kohe e brenda afateve ligjore.

Në funksionet e deleguara

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.8752, dt.26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" dhe ligjit nr.10257, dt.25.3.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8752, dt.26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e Tokës ndryshuar, pranë Këshillit të Qarkut funksionon Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), në përbërje të së cilës janë:

- a) Sektori i Administrimit të Tokës, si funksion i deleguar, i detyrueshëm i Këshillit të Ministrave
- b) Inspektoriati i mbrojtjes së tokës (IMT) funksionet e të cilit mbulohen nga DAMT si funksion i Këshillit të Qarkut.

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës ka për mision menaxhimin e qëndrueshëm dhe efektiv të Tokës Bujqësore në pronësi private dhe shtetërore si dhe monitoron dhe përgjigjet për zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore.

Në këtë kuadër:

1. DAMT-ja mban dhe ruan arkivin me dokumentacionin themelor kadastral, si librat e tokës, librat e ngastrave, planimetritë dhe hartat kadastrale dhe dokumente të tjera të arkivit.
2. Krijon dokumentacion të ri për administrimin e tokës, duke shfrytëzuar përveç dokumentacionit ekzistues dhe atë që disponohet nga institucione të tjera shtetërore dhe që përmban informacion mbi tokën dhe kategoritë e tjera të resurseve.
3. Pëditëson dhe pasqyron në dokumentacionin kadastral ndryshimet e ndodhura në kategoritë toks bujqësore dhe resurseve tjera, që vijnë si pasojë e ligjeve, VKM-ve dhe strukturave tjera shtetërore që kanë tagrin ligjor e kompetencën e ndryshimit të kategorisë së resurseve.
4. Ndjek procesin e plotësimit të Regjistrimit të Tokës Bujqësore në mënyrë manuale dhe dixhitale nga komunat e bashkitë e qarkut dhe në bashkëpunim me Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë, organizon punën për krijimin e Sistemit të Informacionit për Tokën dhe intergrimin gradual të tij në GIS, për të gjitha resurset që ka në administrim, brenda territorit të qarkut.
5. Kryen shërbime dhe jep informacione në bazë të dokumentacionit që disponon, për institucione shtetërore dhe subjekte fizikë e juridikë: për madhësinë dhe vendndodhjen e ngastrave bazë kadastrale të tokës bujqësore, Statusin juridik mbi pronësinë e tokës në zonat kadastrale ku nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar, kategorinë e tokës bujqësore, sipas studimit të bonitetit, sipërfaqet në pronësi private të periudhës para hyrjes në fuqi të ligjit nr.108, dt.29.8.1945 "Për reformën agrare". Të gjitha këto përkundrejt tarifave përkatëse që përcaktohen me Urdhër të Ministrisë të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për subjektet fizike e juridikë, ndërsa ndaj institucioneve shtetërore bëhen falas.

6. Përgatit evidencën e gjendjes dhe të ndryshimeve të kategorive për gjithë territorin e qarkut, evidencën e dhënies me qira të tokës bujqësore nga komunat e bashkitë dhe evidencën e transaksioneve të tokës bujqësore dhe në mënyrë periodike të dhënat e mësipërme dhe çdo informacion tjetër i dërgon Ministrisë Bujqësisë.

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.9244, dt.17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" dhe VKM nr.80, dt.28.1.2005 "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore", pranë DAMT-së, si funksion i Këshillit të Qarkut krijohet dhe funksionon Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës (IMT), që ka për mision mbrojtjen e tokës bujqësore nga faktorë objektivë dhe subjektivë.

Për këtë:

1. Programon punën dhe ushtron kontrole metodike, të zakonshme që organizohen dy herë në vit (prill-maj dhe shtator-tetor) dhe kontrole operative pë çështje të veçanta që organizohen në vijimësi
2. Objekt kontrolli janë masat për mbrojtjen dhe rehabilitimin e tokës bujqësore
3. Mban akte-verifikimi dhe pezullimi si dhe në raste të shkeljeve të dispozitave ligjore merr masa për vendosjen e gjobave.
4. Harton raportin përmbledhës në shkallë qarku për kontrollin e ushtruar, ja paraqet Kryetarit të Këshillit të Qarkut dhe ky raport analizohet në mbledhjen e Komisionit të Mbrojtjes së Tokës në qark.

Sa mësipër, për vitin 2014 nga DAMT-ja janë realizuar objektivat dhe detyrat që janë përcaktuar me ligje të posaçme si nga Sektori i Administrimit të Tokës Ashtu edhe nga Sektori i Mbrojtjes së Tokës (IMT-ja).

Për vitin 2014 nga Sektori i Administrimit të Tokës janë siguruar rreth 680.000 lekë të ardhura nga shërbimet që kryejmë dhe tarifatat përkatëse sipas Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë

Buxheti i vitit 2016

Në zbatim të Ligjit Nr 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit 9936 dt 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr 7776 dt 22.12.1993 "Për Buxhetin lokal" ndryshuar me Ligjin Nr 8399 dt 09.09.1998, ligjit nr. 147/2015, date "Per buxhetin e vitit 2015", Udhezimit te Ministrise se Financave nr. 2, date 6.02.2012 "per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", Udhezimit Plotesues nr. 1, date 15.01.2016 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2014", grupi i punes i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës, pasi mblodhi të dhënat nga Sektoret përkatëse detajoi Buxhetin e vitit 2016, e zhvilloi treguesit ekonomik – financiar në përputhje me strategjinë dhe politikën e zhvillimit rajonal.

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

Programi i arsimit parauniversitar ne pamundesi te financimit nga buxheti i Keshillit te Qarkut,eshte mbeshtetur dhe do te vazhdoje te mbeshtetet edhe nepermjet projekteve te ndryshme e ne vecanti arsimi apo kualifikimi profesional

Buxheti i vitit 2016 ka këto burime financiare:

- A. Të ardhurat

- B. Transferta e pakushtëzuar (ose Granti) 28.470.211 leke

A. Të ardhurat

Të ardhurat përbëhen nga:

1. Të ardhurat e planifikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2016

2. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2015 15.557.002

A.1. Të ardhurat e planifikuara per vitin 2016 janë :

_____ leke.

A.2 .Të ardhurat e trashëguara nga viti 2015 janë: 15.557.002leke

Parashikimi i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, për t'u realizuar në vitin 2016, si dhe atyre të trashëguara, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Vlera
A.1.	Të ardhura të parashikuara për vitin 2016	18000
a.	Leje Zhvillimi	0
b.	Leje shfrytëzimi, përdorimit	500
c.	Leje transporti	600
d.	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1000
e.	Kontributi nga Komuna dhe Bashki	3500
f.	Te ardhura nga Proj.IPA *Cross Border*	10,000
g.	Te ardhura nga qerate	2400
A.2.	Të ardhura të trashëguara nga viti 2015	15557
B.	Transferta e pakushtëzuar për vitin 2016	28470
	Totali	62027

A.1. Të ardhurat e planifikuara për vitin 2016 dhe të analizuarat zë për zë janë:

a,b. Të Ardhurat nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Viti 2016 ashtu si dhe viti i kaluar vazhdon te paraqese nje ndryshim rrenjesor ne planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit te territorit ne mbare vendin. Kjo pasqyrohet nepermjet ndryshimit te te gjithe kuadrit ligjor me te cilin eshte operuar deri tani ne kete fushe. Kjo reforme, sipas ligjit, shoqerohet me nje periudhe tranzitore kohe gjate se ciles duhet te hartohen dhe instrumentat e planifikimit. Natyrisht kjo do te sjelli nje efekt ngadalesues ne fushen e ndertimit, nuk parashikohen te ardhura ne proekt buxhet

Nderkohe qe per vitin 2016 jane parashikuar 500,000 leke te ardhura nga lejet e perdorimit duke marre parasysh objekte qe kane perfituar leje ndertimi vitet e fundit dhe qe sipas afatit i takon te kerkojne pajisjen me leje perdorimi

Te ardhura nga arkivat teknike jane parashikuar duke marre parasysh ecurine normale vjetore te vitit te kaluar.

c. Tarifa e transportit rrugor

Ne zbatim te nenit 5 te ligjit nr.8308 date 18.03.1998 ‘Per transportet rrugore’ te ndryshuar, ne zbatim te politikave te qeverise, Ministri I Puneve Publike dhe Transportit, ka bere ndryshime ne Udhëzimin nr.15 date 24.07.2007 ‘Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licensave, autorizimeve dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor’. Keshilli I Qarkut pajis me license dhe certificate per transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit, vetem subjektet qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne komunat e qarkut. Te ardhurat per vitin 2015 jane realizuar ne masen 80% , ndersa te ardhurat nga kjo tarife te parashikuara per vitin 2016 jane parashikuar ne nje rritje prej 20%.

d. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve

Burimet për këte të ardhur janë nga procedurat e aplikuara nga dy Drejtori, ajo e Urbanistikës dhe e DAMT-së.

Nga drejtoria e Urbanistikës kjo tarifë aplikohet për shërbimet që u ofrohen prej saj subjekteve ndërtuese.

Per vitin 2016 te ardhurat nga ky sherbim jane realizua 710 mije leke.

Nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes ne Qark keto te ardhura jane parashikuar nga sherbimet qe kryen kjo drejtori ndaj qytetareve.

Për vitin 2016 kjo e ardhur është planifikuar **1.000 mije leke.**

e. Te ardhura nga Kontributet e Komunave dhe Bashkive ne Qarkun e Durrësit

Në zbatim të ligjit Nr 8652 dt 31.07.2000 ‘Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore’, neni 18, pika 2, nenit 54 pika b, neni 73 pika 8, Udhëzimit nr.1 dt 21.01.2010 të Ministrisë së Financave ‘Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2010’ pika 87, ‘Të ardhurat e qarqeve nga kuotat e njëjësive vendore’, Komunitet dhe Bashkitë përbërëse në Qark derdhen një kuotë në favor të Këshillit të Qarkut e cila shërben si e ardhur për Këshillat e Qarkut.

Realizimi i këtij zëri për vitin 2015 ka qenë në vlerën 8.700mije/lekë nga **14,000 mije/leke** te planifikuar ne buxhet.

Per vitin 2016 kjo e ardhur, duke u bazuar edhe në mirkuptimin e pritshëm nga Bashkitë për rëndësinë e derdhjes së këtij kontributi, është planifikuar në vlerën **3.500 mijë/ lekë**(mbasi eshte vit i zbatimit te reformes teritoriale)

A.2. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2015 janë 15.557 mijë/lekë.

B. Te Ardhurat nga Transferta e Pakushtezuar

Transferta e pakushtezuar (ose Granti) është e ardhur e përfituar nga pushteti qendror në formë dhurimi, pa kusht kthimi dhe pa interes.

Për vitin 2015 kjo Transfertë ka ardhur **28.470 mijë lekë**, (rreth 35.145 mijë/ lekë me pak se transferta e ardhur në vitin 2015).

Ky pakesim ka ardhur dhe si rrjedhoj i transferimit te aktivitetit te Ndermarrjes se Rrugeve Rurale me VKM 915 dt. 11.11.2015 ne varesi te Bashkise Durres

II.1. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2016

Vlera totale e shpenzimeve të përgjithshme per vitin 2016, sipas funksioneve të Këshillit të Qarkut, parashikohet të jetë **107,309 mijë leke**.

II.1.1. Shpenzime Personeli(ART.600+601)

Shpenzime për paga e shtesa mbi paga (artikulli 600)

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për pagën bazë e shtesat mbi pagë. Këtu përfshihen pagat e administratës së Këshillit të Qarkut.

Planifikimi i shpenzimeve te personelit është bërë duke pasur parasysh numrin e punonjësve dhe strukturen e nivelin e pagave sipas Vendimin **586 dt 17.07.2013** “Për disa ndryshime në VKM nr 1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësive të Qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes vendore” ,Ligjin nr.147/2015 “Per buxhetin e vitit 2016”, Ligjin 8652, data 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit 9936 dt 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e K.Qarkut _____ “Për disa ndryshime në V.K.Q “Për Miratimin e Pagave të punonjësve të zgjedhur dhe te emëruar në Këshillin e Qarkut” dhe Vendimin e.K.Qarkut “Për miratimin e strukturës se aparatit te Keshillit te Qarkut për vitin 2016”.

Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (artikulli 601)

Kontributi i Sig.Shoq dhe shëndetësore, ne zbatim te V.K.M.Nr 1114 dt 30.07.2008, ndryshuar me VKM nr.457,date 09.07.2014, është llogaritur respektivisht në masën 16.7% nga punëdhënësi dhe 11,2% nga punëmarrësi.

Fondi i pagave mbi të cilin llogaritet kontributi i sig.shoq dhe shëndetësore është llogaritur sipas V.K.M.Nr 457, date 09.07.2014 “Paga minimale për efekt llogaritje të sigurimeve shoqerore është 22000 lekë, kurse paga maksimale 97.030 lekë.

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

Masa e shpërblimit të Këshilltarëve është parashikuar 10 % e pagës së Kryetarit të KQ, si për anëtarët e kryesisë ashtu edhe për anëtarët e Këshillit të Qarkut.

Llogaritja e fonti per paga keshilltare eshte mbeshtetur ne VKM _____ dt _____

Per _____ ku eshte parashikuar pagesa per 3 keshilltaret.....

Ne Shpenzime Personeli (ART.600+601) per aparatin e Keshillit Qarkut, jane planifikuar dhe efektet financiare te mbylljes se Ndermarrjes se Rrugeve Rurale sipas VKM.915 date 11.11.2015.

Në 000/lekë

Art	Emërtimi	Plani viti.2016
600	Paga ,shtesa, etj	13.000
601	Sig.Shoq	2.200
	Totali per aparatin	15200
600	Paga punonj.NRR	2200
601	Sig.Shoq.	370
600	Efekte te Ristrukturimi N.Rr.R.	1882
	Shuma per N.R.R.	4452
600	Demshperblim per pun.ap.ristrukt	
600	Detyrime per paga aparati projektet	1620
	Totali shpenzimeve personeli	

II.1.2.Shpenzime Operative dhe të mirëmbajtjes (Art. 602)

Në 000/lekë

Art	Emërtimi	Plani viti.2015	Plani viti.2016
602	Shp.Operative (pa keshilltar)		
6020	Materiale , shërb. zyre e të përgj.	832	250
6021	Materiale dhe shërbime speciale	200	100
6022	Shërbime	2145	2700
6023	Shpenzime transporti	2644	1880
6024	Shpenzime Udhëtimi	2318	3050
6025	Mirëmbajtje të zakonshme	900	2100
6029	Shp.tj. op.pj.konfer.,v.gjyq,komision	4295	6250???
602	Pagesa për këshilltarët+det.2014	8008	840
	Shpenzime operative + keshilltare	18,064	24,028

*) Në shpenzimet operative për Këshillin e Qarkut Durrës janë përfshirë edhe "Pagesat për Këshilltarët", të cilat janë planifikuar në masën **8,008 mije** lekë ku 1,144 mije leke jane

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

detyrimet e prapambetura per vitin 2014, shpenzimet per zbatimin e Vendimeve Gjyqesore, shpenzime te sigurimit dhe ruajtjes godines, etj te cilat ndikojne ndjeshem ne rritjen e ketij zeri shpenzimesh.

II.1.3 Planifikimi i shpenzimeve të tjera (604,605,606)

*Në këto zëra janë planifikuar fonde si më poshtë:
në 000/lekë*

	Viti 2015	Viti 2016
• Financimi i Shoqatës Ryder	500	---
• Financ. Shoq. Verbërve Durrës, Krujë	50	50
• Kuota e antarësimit tek Shoqata e Adriatikut	0	0
• Kuota e anëtarësimit në AER	480	300
• Financime për mbështetjen e projekteve IPA	1,000	----
• Mbeshtetje e Komunitetit Rom	20	20
• Kuote anetar.ADRIGOV+CRPI	150	250
• Kuote anetar.shoq.Qarqeve	--	300
Shuma për Shpenzime të tjera	2.200	920

II.1.4 Fondi rezervë dhe i kontigjences (Art. 609)

Në buxhetin e vitit 2014 fondi rezervë dhe i kontigjences janë parashkuar në zbatim të legjislacionit dhe udhëzimeve për hartimin e buxhetit në masën jo më shumë se 3% të shpenzimeve totale, e perkatesisht:

Për Fondin rezervë _____ lekë
Për Fondin e Kontigjencës _____ lekë

II.1.5 Planifikimi i investimeve (Artikulli 230, 231)

I detajuar zëri shpenzime për investime paraqitet si më poshte,

• **Tabela nr.10 000/lekë**

		Plan V.2015	Plan 2016
	INVESTIME DHE STUDIME	2.895	2,895
231	Blerje paisje kompjuterike	200	0
231	Blerje paisje zyre (kondicioner etj)	200	0
231	Supervizor+kolaudator	600	450
231	Blerje paisje per disiplinimin e parkimit te mjeteve	200	950

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

231	Rifreskim I paisjeve te rrjetit	384	0
231	Rik.rrug.Gjepalaj pa lik 2013	1256	0
231	Rikonstruksion lapidare e simbole lufte	55	0
230	Master Plani Lokal, Komuna Bubq,v.2013	0	1080

1. Nga Grantet konkurruese Keshilli i Qarkut Durres per vitin 2015 do te siguroj financimin per shumen 13,708,846 leke per objektin Rikonstruksioni i rruges nacionale Qender- Maskuri,i cili ka perfunduar.

2. PROGRAMI PER KUJDESIN SOCIAL 70 mije/lek

- Financ. Shoq.Verbërve Durrës, Krujë 50 «
- Financ. Shoq.Romeve 20 «

Prioritetet e Sektorit Projekteve per vitin 2016.

Sektori ka punuar per implementimin e objektivave nepermjet 2 drejtimeve:

- *Perthithjes dhe implementimit te sa me shume projekteve te inkuadruar ne programe te brendeshme dhe te huaja ne interes te Komunitetit te Qarkut dhe zhvillimit social ekonomik.*
- *Nepermjet programit te perkujdesit shoqeror per te gjitha grupet dhe shtresat ne nevoje*

Drejtimi Pare

Gjate vitit 2015, i eshte kushtuar rendesi perfundimit te procedurave financiare te mbylljes te projektit **DELMVET** – Zhvillimi i nje Modeli Efikas te Menaxhuar ne nivel Lokal te AFP, dhe **S.T.A.R.** te implementuar nga Keshilli i Qarkut Durres ne kuadrin e Programit IPA Cross Border.

Gjithashtu eshte punuar ne kuader te projektit “ZERO WASTE”, I cili eshte mbyllur me sukses nga ana e Keshillit te Qarkut Durres. Ky projekt eshte ne procesin e mbylljes perfundimtare te tij nga ana e Partnerit Leader. Ne kuader te ketij projekti mbeten te vijne rimbursimet per 5 Progres Raporte, si edhe dy progress raportet e fundit te aprovohen nga Zyra Kontrollit Nivelit Pare prane Ministrise se Integritimit Tirane.

Projekte te Tjere

Eshte punuar ne drejtim te thithjes dhe aplikimit te projekteve te tjere ne kuader te programeve si: ERASMUS, ERASMUS+, HORIZON 2014-2020, COSME, SOUTH EAST EUROPE, ETJ. Disa nga projektet ku eshte aplikuar jane:

- EuroDea Scarl
- In2MED STARTER
- CoastMED
- 2Stainable
- SuCSuT
- SYNGGI
- MaReCoAST-HoP

Keto projekte janë kryesisht në fushën e turizmit, ambientit dhe perkrahjes sociale.

Drejtimi Dytë

Programi i kujdesit social parashikon hartimin e programeve të kujdesit social në nivel qarku për të gjitha shtresat dhe grupet në nevojë.

Qellimi:

Mbulimi i nevojave ekonomike dhe sociale të grupeve në nevojë në Qarkun e Durresit, duke siguruar një mjedis favorizues për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin maksimal të individëve, në aspektin e zhvillimit fizik, mendor, shpirtëror, moral, psikologjik dhe social, në përputhje me dinjitetin njerëzor. Shërbimet shoqërore do të kontribuojnë për ruajtjen e pozitës së individëve në shoqëri dhe për t'i mbrojtur ata nga përjashtimi social.

Objektivat :

- d. Sigurimin e mbulimit të nevojave ekonomike dhe sociale të familjeve dhe individëve në nevojë në Qarkun e Durresit, duke i ri-integruar përfituesit në ambientin shoqëror, duke i harmonizuar programet e mbrojtjes dhe të zhvillimit social dhe duke i transformuar në një instrument aktiv të zhvillimit shoqëror,
- e. Vazhdimi i mbështetjes financiare të Shoqatës së të Verberve Durres - Krujë, e cila do të ofrojë gjatë 2015, shërbime të integruara për këtë grup social, duke përbushur nevojat sociale të këtij grupi.
- f. Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet organeve lokale të nivelit të parë për përmirësimin e shërbimeve sociale sipas standarteve bashkëkohore.

Në zbatim të politikave të Keshillit Qarkut Durres, për të bërë të mundur ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbështetje financiare në Keshillin e Qarkut funksionojnë:

5. Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Qark.

Bazuar në Ligjin Nr.10347, dt.04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve", Keshilli i Qarkut Durres ka ngritur Njësine për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për Qarkun Durres.

Aktualisht Keshilli Qarkut Durres ka bashkëpunuar me UNICEF-in me qëllim ngritjen dhe funksionimin e Njësise. Në kuadër të këtij bashkëpunimi Keshilli Qarkut Durres ka marrë një sërë trainimesh të stafit, mbështetje financiare dhe asistencë teknike për këto projekte.

6. Komiteti Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve Komunitare në Qark

Ka funksionuar organizimi dhe mbledhja e Komitetit të Vlerësimit të Nevojave për Qarkun Durres, në bashkëpunim me Ministrinë e Linjes dhe UNDP, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Romët dhe Plan Veprimtarë të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2010 -2015". Gjatë këtij viti, ky Komitet u mblodh në takim e radhës ku u analizuan dhe u evidentuan gjendja dhe problemet e komunitetit rom në Qarkun Durres, në mënyrë që të elimonohen sa më shumë në të ardhmen për të bërë të mundur integrimin e plotë të këtij komuniteti në jetën sociale ekonomike të Qarkut.

4. Grupi Teknik për Çështjet Rome në Qark

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom, Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen e Dekadës Rome dhe Udhezimeve të Ministrisë së Linjes, Këshilli i Qarkut Durrës, pasi ngriti Grupin Teknik, me anë të Urdhrit të Brendshëm Nr.97, dt.27.12.2011, ka bërë evidentimin në kohe reale të situatës social-ekonomike, vlerësimin sasior dhe cilësor të nevojave të komunitetit Rom, grumbullimin dhe koordinimin e të dhënave statistikore të siguruar në rrugë zyrtare dhe jo zyrtare, për të përcaktuar shkallën e vulnerabilitetit dhe përjashtimit social që përjeton komuniteti Rom, shfrytëzimin e burimeve lokale për të siguruar një akses më të madh të këtij komuniteti për shërbimet që ofrohen në nivel qarku

- Në bashkëpunim me UNDP, Këshilli i Qarkut Durrës, ka nënshkruar një Akt-Marrëveshje Bashkëpunimi në kuadër të Programit të përbashkët "Fuqizimi i Komuniteteve lokale në nevojë në Shqipëri", me qëllim përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Romët dhe Plan Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2010 -2015" duke monitoruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare, dhe ofruar ndihmë për forcim kapacitetesh lokale në mbështetje të Komunitetit Rom në nivel lokal.
- Grumbullimin dhe koordinimin i të dhënave statistikore sipas fushave prioritare të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit "Për Dekadën e Përfshirjes së Komunitetit Rom" të siguruar në rrugë zyrtare dhe jo zyrtare.
- Mbledhje periodike të të dhënave nga njësitë vendore, sipas indikatorëve të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom.
- Hedhjen e tyre në sistem web-based online, trajnuar nga PNUD dhe MPunes, dhe pajisur me User name dhe Password për të loguar në këtë program web-based, me qëllim raportimin periodik në kuadër të monitorimit të Strategjisë Kombëtare.
- Bashkëpunim me UNDP, për funksionimin e GTÇR duke ofruar ndihmë për forcim kapacitetesh lokale në mbështetje të Komunitetit Rom në nivel lokal.

Mbështetje shoqatave

Koordinimi, mbledhja e dokumentacionit, orientimi dhe hartimi i Akt-Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Qarkut dhe organizatave të ndryshme, projekt-propozimet e të cilave janë bashkë financuar nga Këshilli i Qarkut si më poshtë vijon:

• *Shoqata e të Verbërve Durrës / Krujë*

Mbështetur në V.K.M. nr. 549, dt.07.11.2002 për një ndryshim në V.K.M. nr. 277, dt. 18.06.1997 "Për përfitimin nga Statuti I të Verbërve", Këshilli I Qarkut Durrës prej vitesh ofron mbështetje financiare sipas një marrëveshjeje të nënshkruar ndërmjet dy palëve, Shoqatës së të Verbërve Durrës dhe Krujë, në mbështetje të projektit të zbatuar nga këto dy shoqata. Për vitin 2015 kjo shoqatë është mbështetur me 50.000 lek.

Projekti ka për qëllim:

3. Përmirësimin e jetës së të verbërve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne për eliminimin gradual të barrierave informuese të personave të verbër dhe,
4. Sigurimin e mbështetjes dhe përfshirjen e të verbërve në veprimtaritë kulturore sportive dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së tyre në veprimtari rajonale dhe kombëtare.

• *Shoqata Rome*

Bazuar në VKM nr. 563, dt.12.08.2005 "Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore" dhe në mbështetje të Planit Kombëtar të Veprimit, konkretisht fushës së gjashtë prioritare **Trashëgimia Kulturore**, me qëllim strategjik: *Ruajtja dhe*

Zhvillimi i Trashëgimisë Kulturore të Minoritetit Rome si një Element i Integruar në Trashëgiminë Kulturore Kombëtare dhe, Nxitja e Respektit të të Rinjve ndaj Diversitetit Kulturor, Këshilli i Qarkut Durrës për vitin 2015, parashikoi në buxhetin e tij, një shumë simbolike në mbështetje të projektpropozimeve nga organizata rome, që parashikojnë aktivitete në shërbim të komunitetit rom.

Lidhur me **drejtimin e dyte**, për mbledhjen e informacionit dhe mbajtjen lidhje me institucionet dhe organizatat që veprojnë në Qarkun e Durrës, si edhe me Ministrinë, janë mbajtur lidhje me: **Fondi Shqiptar i Zhvillimit; UNDP (PMUD);**

Këshilli Qarkut Durrës është bërë pjesë e Programit për Zhvillimin Lokal dhe Decentralizimin, (dldp) me qëllim ndërtimin e kapaciteteve të NJQV të qarkut për të ofruar shërbime efikente në fushën e menaxhimit të mbetjeve bazuar në praktika të mira dhe objektivat strategjike për këtë sektor.

Ministrinë e Linjes: Gjate vitit 2015 është punuar edhe në drejtim të mbledhjes dhe ofrimit të informacionit ndaj Ministrive të Linjes si korrespondenca e mbajtur me Ministrinë e Brendshme lidhur me rritjen e aftësive të bashkëpunimit të njesive vendore. Gjithashtu është punuar me Ministrinë e tjera të linjes lidhur me sasitë e mbetjeve të ngurta dhe inerte, vend depozitimit të tyre, etj.

Prioritetet e Sektorit Projekteve për vitin 2016.

Gjate vitit të ardhshëm, sektori i projekteve do të punojë në drejtimet e mëposhteme:

- Rritja e bashkëpunimit me njesitë administrative, bashki në Qarkun Durrës duke bërë përditesimin e data base të këtyre njesive, me qëllim njohjen nga afër të nevojave të komuniteteve të tyre. (Gjate gjithë vitit)
- Rritja dhe intensifikimi i punës dhe bashkëpunimit me njesinë e implementimit të projekteve për vazhdimin përhapjen sa më mirë dhe gjere të përvijes së fituar në implementimin e projektit pilot në kuadër të projektit DELMVET, për përfundimin me sukses të procesit mesimor 1 vjeçar në shkollën “Beqir Cela” në klasat e 2 profileve me të nevojshme në tregun e punës. (Janar – qershor)
- Përditesimi dhe mirëmbajtja e faqes web të projektit DELMVET, pasurimi i database me të dhëna të tjera nga subjektet e AFP në vend dhe nga Partneret e projektit. (Gjate tërë vitit)
- Kërkimi dhe hartimi i projekteve të rinj në ndihmë të komunitetit të Qarkut, si në kuadër të programit IPA CROSS BORDER, Adrigov, Interreg MED, Balkan MED, etj., ashtu edhe në bashkëpunim me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. (gjate gjithë vitit)
- Pjesëmarrje aktive në seminar edhe trainime të organizuara në nivel rajonal dhe ndër rajonal. (gjate gjithë vitit)
- Implementimi dhe mbështetja e programit të kujdesit social duke parashikuar hartimin e programeve të kujdesit social në nivel qarku për të gjitha shtresat dhe grupet në nevojë. (gjate gjithë vitit)
- Vazhdimi i mbështetjes financiare të Shoqatave të ndryshme të Qarkut Durrës, si Shoqata e të Verberve Durrës - Kruje, Shoqata Ryder Albania, Shoqata e Invalideve të Punes Dega Durrës, Komuniteti Rom, duke ofruar gjate 2016, shërbime të integruara për këto grupe sociale në nevojë. (Gjate vitit)

PROGRAMI I TURIZMIT DHE KULTURES NE QARKUN E DURRESIT PER VITIN 2016

3. Pjesëmarrja dhe organizimi i workshopeve dhe trainimeve në fushën e turizmit

Zhvillimi i turizmit, veçanërisht zhvillimi i qendrueshëm i turizmit që është edhe objektivi kryesor për turizmin në qarkun Durrës është një problem mjaft kompleks i cili varet nga faktorë të shumtë ekonomik, social, lokal, mjedisor, rajonal-kombëtar dhe ndërkombëtar. Pikërisht për të realizuar këtë objektiv shërben edhe organizimi i trainimeve dhe pjesëmarrja në workshope, për shkëmbim eksperiencash dhe përfitim nga “praktikat më të mira” në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Qarku i Durrësit ka marë pjesë vazhdimisht në trainime të ndryshme për turizmin oranzuar nga ATA, PKPPSH- Programit Kombëtar për Prodhim të Pastër në Shqipëri-Përgjegjësia Sociale vs Zhvillimi i Qëndrueshëm i Turizmit dhe semianre të ndryshme në fushën e turizmit dhe mjedisit.

FINACIMI

KQD

ZERO WASTE

4. Përgatitja dhe publikimi i materialeve promovuese për turizmin

Publikimi i materialeve promovuese është një faktor i rëndësishëm që i shërben promovimit të turizmit të qarkut Durrës. Qarku Durrës ndër vite ka nxjerrë një sërë publikimesh, CD e broshurash për të promovuar pasuritë e mëdha natyrore, historike-kulturore. Ato më të suksesshmet janë; Gazeta “Aromë Deti”, “Guida turistike e Durrësit”, broshura “Durrësi Porta shqiptare e perëndimit drejt lindjes”, CD “Qarku Durrës”, “Komuna Ishëm si një pasuri turistike” CD, “Java Europiane 2010 në Durrës”, broshura “Udhëzues për zonat e lagura bregdetare të Shqipërisë”, realizuar në kuadrin e projektit AMJOWELS, broshura “Hadriatikum”, CD “Projekti Hadriatikum” realizuar në kuadrin e Projektit HADRIATIKUM etj, një numër materialesh promovues të projektit STAR dhe projektit Zero Waste të përdorur për evente të ndryshme, panaire dhe worshope lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në vazhdim të kësaj eksperience të gjatë dhe të larmishme në këtë kuadër do të realizohen gjatë vitit 2015 të tjera materiale promovues të Projektit Zero Waste, projekt i cili zgjat deri në korrik të 2015.

FINACIMI

KQD

Projekti Zero Waste

5. Identifikimi dhe promovimi i të gjitha monumenteve të kulturës, historisë dhe arkeologjisë me vlera të mëdha duke krijuar një database me të gjitha monumentet e kulturës dhe të natyrës që zotëron qarku i durrësit

Sektori i Turizmit në Qarkun e Durrësit ka një bazë mjaft të mirë të dhënash për monumentet kulturore dhe natyrore të qarkut të Durrësit të cilat janë pasqyruar vazhdimisht në gazetën lokale të Qarkut të Durrësit dhe në ato kombëtare edhe me kontributin e DKPQ dhe Sektorit të Turizmit në KQD, përmendim këtu gazetën “Arome Deti” etj

Kontribut në promovimin e vlerave kulturore në Qarkun e Durrësit ka dhënë edhe realizimi i projektit HADRIATIKUM që ka bërë dixhitalizimin e veprave letrare me rëndësi historike në Qarkun e Durrësit.

Gjithashtu këtij promovimi i shërben dhe publikimi i materialeve për qarkun e Durrësit në Website të Projektit STAR që u mbyll në mars 2014, si dhe projekti Zero Waste adriatic net for events and festivals që është në zbatim nga KQD.

Gajtë vitit 2014 në bashkëpunim me njësitë vendore të KQD u punua për të pasuruar bazën e të dhënave për monumentet kulturore që ndodhen në qarkun e Durrësit dhe për pasuritë natyrore të Qarkut të Durrësit duke bashkëpunuar edhe me MZHUT. Promovimi i vlerave dhe monumenteve në Durrës në shërbim të turizmit do të jetë prioritet edhe gjatë 2015 duke patur parasysh që nevoja për promovimin e vlerave arkeologjike, historike, kulturore, arkitekturore, ekonomike dhe turistike të qytetit të Durrësit kërkon një impenjim më konstant edhe në mediat kombëtare. Vlerat e këtij qyteti duhet të promovohen në mbarë hapësirën kombëtare, në funksion të rritjes së fluksit turistik dhe të zhvillimit ekonomik-shoqëror të qytetit me fokus zhvillim turistik miqësor me mjedisin dhe me një shtrirje gjithë vjetore.

Aspirohet për krijimin e një database me monumentet kulturore dhe natyrore të qarkut Durrës, në kohën e sotme kur teknologjia e informacionit është gjuha e së ardhmes, si mënyrë që do ti shërbente më së miri promovimit të qarkut Durrës në rajon dhe më gjerë.

Vlen të theksohet fakti që Sektori i Turizmit në Qarkun e Durrësit ka një eksperiencë mjaft të mirë në këtë drejtim duke patur parasysh që ka realizuar me sukses Projektin Hadriatikum i cili kishte si objekt kryesor të tij krijimin e një portali web www.hadriatikum.it i cili ishte në thelb një database me veprat e shkruara letrare dhe historike të hershme në zonën e vendeve të Adriatikut.

6. Identifikimi dhe regjistrimi i të gjithë operatorëve dhe njësive që veprojnë në sektorin e Turizmit, organizimi dhe grumbullimi i të dhënave të sakta statistikore të infrastrukturës turistike mikpritëse, me qëllim njohjen e gjendjes dhe hartimin e politikave të sakta rajonale

Sektori i Turizmit ka marrë dhe po merr vazhdimisht të dhëna në lidhje me këtë objektiv nga institucionet përkatëse lokale dhe qendrore (INSTAT, Zyra e Taksave, Bashkitë, Komunitet etj.)

Projekti STAR i zbatuar nga Sektori i Turizmit në Këshillin e Qarkut Durrë deri në Mars 2014 krijon një infrastrukturë online të mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e turizmit. Objekti i përgjithshëm i Projektit ishte krijimi i një sistemi informacioni për turizmin në zonën e adriatikut, duke e trajtuar informacionin turistik si çelësin e rrisë për të mbështetur një turizëm me eficient dhe të qëndrueshëm. Në funksion të këtij objekti të përgjithshëm projekti ka këto objektiva specifike:

- Krijimin e një portali të përbashkët të dhënash turistike për zonën e Adriatikut
- Shërkmbimin e praktikave më të mira në lidhje me menaxhimin e turizmit, analizat dhe transmetimin e të dhënave
- krahasimin dhe përmirësimin e rregullave dhe rregulloreve e vendeve të adriatikut në lidhje me të dhënat në fushën e turizmit
- rritjen dhe homogjenizimin e të dhënave cilësore dhe sasiore në sektorin e turizmit

- sigurojë për ndërmarrjet turistike një instrument të ri për tu përballur në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar
- ndarja e informacionit turistik për vendet e adriatikut në mënyrë elektronike duke përmirësuar dhe lehtësuar promovimin e destinacioneve turistike në rajonin e adriatikut.

Në kuadrin e këtij projekti Qarku i Durrësit si partner ndërmari një sërë aktivitete nga të cilat më kryesori ishte realizimi nga Sektori i Turizmit në Keshillin e Qarkut Durres i një portali Eeb i cili do të bëjë regjistrimin e të dhënave për turizmin në rrjet duke mundësuar përdorjen e një portali të përbashkët të të dhënave statistikore për turizmin në vendet e Adriatikut, që është edhe qëllimi kryesor i projektit edhe pas mbarimit të fazës së implementimit.

Ky portal do të krijojë mundësinë e furnizimit të vazhdueshëm me të dhëna për turizmin në zonën e Adriatikut si edhe mundësinë e shkëmbimit të informacionit dhe të përdorimit të tij për qëllimet e promovimit dhe zhvillimit progresiv të turizmit.

7. Bashkëpunimi efektiv nëpërmjet operatorëve publike dhe private sidomos në drejtim të hartimit të paketave turistike me qëllim rritjen e ditë qëndrimeve të turistëve e vizitorëve gjatë gjithë vitit në qarkun e Durrësit.

Qarku i Durrësit dhe aktualisht Sektori i Projekteve në bashkëpunim me Sektorin e Turizmit do të interesohet të aplikojë në vazhdim për disa projekte në fushën e zhvillimit të turizmit në rrjet dhe hartimit të paketave turistike:

FINACIMI NGA IPA PROGRAM DHE IADSA në kuadrin e AIE

8. Hartimi i pyetësoreve për turizmin për të përcaktuar tendencën e zhvillimit të turizmit në qarkun e Durrësit

Ky objektiv do të arrihet në kuadrin e Projektit STAR ku hartimi i pyetësoreve dhe intervistimi i grupeve të interesuara janë nga objektivat kryesore të projektit. Analizimi i rezultateve të këtyre intervistave do të ndihmojë për të përcaktuar tendencën e zhvillimit të turizmit në qarkun e Durrësit.

9. Përgatitja e studimeve, kërkimeve, diskutimeve dhe artikujve shkencore për turizmin në funksion të nxitjes së turizmit në Qarkun e Durrësit

Sektori i Turizmit në qarkun e Durrësit prej marsit 2014 është pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe një nga objektivat kryesore të tij ndër vite pa patur edhe realizimin e studimeve dhe artikujve për turizmin që i shërbejnë nxitjes së turizmit dhe hartimit të strategjive dhe politikave për zhvillimin e turizmit në qarkun e Durrësit. Deri tani ky sektor ka kryer me sukses një sërë studimesh e diskutimesh për turizmin në qarkun e Durrësit një pjesë e të cilave janë referuar dhe botuar edhe në aktivitete botime ndërkombëtare. Mund të përmendim këtu “Turizmi kulturor në kuadrin e strategjisë së zhvillimit në Qarkun e Durrësit” mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare për Turizmin kulturor realizuar për turizmin në Durrës në kuadrin e AER, “Prezantim për zhvillimin e turizmit në Qarkun e Durrësit” mbajtur në kick off meeting të projektit STAR Bolonja Maj 2011, Studim për zonat

e lagështa bregdetare në Qarkun e Durrësit i përfshirë në broshurën “Udhëzues për zonat e lagura bregdetare në Shqipëri” produkt i projektit AMJOËELS, prezantuar në panairin Mediterr në Fiera del Levante Bari. Artikulli “Substantial Tourism and AER Contribution in Durrës Region” botuar ne Regional Revieë publikim zyrtar i AER etj. Studime për gjendjen e mbledhjes së të dhënave realizuar në kuadrin e projektit STAR dhe të publikuara në trajtën e broshurave të ndryshme.

Në vazhdim të kësaj praktike të mirë edhe gjatë 2016 do të bëhen studime në përputhje me situatat dhe objektivat aktuale.

4.PROGRAMI I ARSIMIT PARA-UNIVERSITAR

Qellimi i Programit

- Edukimin e brezit të ri përmes politikave të caktuara sociale, kulturore dhe edukative.

Produktet e politikës së programit për vitin 2015

- ❖ Rritja dhe intensifikimi i punës dhe bashkepunimit me njesinë e implementimit të projekteve për vazhdimin e organizimit të aktiviteteve në kuadër të projektit DELMVET, për të mundësuar implementimin sa më të suksesshem dhe në kohë reale të planeve të punës dhe për të realizuar një produkt sa më konkret në pilotimin e 2 profileve me të nevojshme në tregun e punës. (Janar – Mars)
- ❖ Ndjekja e mbarevajtjes së pilotimit të dy profileve pranë Shkolles profesionale „Beqir Cela“ në kuadër të Projektit DELMVET. (Shkurt – Dhjetor)
- ❖ Perditesimi dhe mirembajtja e faqes web të projektit DELMVET, pasurimi i database me të dhëna të tjera nga subjektet e AFP në vend dhe nga Partneret e projektit. (Gjate tërë vitit)
- ❖ Rritja dhe intensifikimi i punës dhe bashkepunimit me njesinë e implementimit të projekteve për vazhdimin e organizimit të aktiviteteve në kuadër të projektit DELMVET, për të mundësuar implementimin sa më të suksesshem dhe në kohë reale të planeve të punës dhe për të realizuar një produkt sa më konkret në pilotimin e 2 profileve me të nevojshme në tregun e punës. (Janar – Mars)
- ❖ Ndjekja e mbarevajtjes së pilotimit të dy profileve pranë Shkolles profesionale „Beqir Cela“ në kuadër të Projektit DELMVET. (Shkurt – Dhjetor)
- ❖ Perditesimi dhe mirembajtja e faqes web të projektit DELMVET, pasurimi i database me të dhëna të tjera nga subjektet e AFP në vend dhe nga Partneret e projektit. (Gjate tërë vitit)

Prioritetet e Sektorit Projekteve për vitin 2016.

Gjate vitit 2016, sektori i projekteve do të punojë në drejtimet e mëposhteme:

- Rritja e bashkepunimit me njesite vendore, bashki ne Qarkun Durres duke bere perditessimin e data base te ketyre njesive, me qellim njohjen nga afer te nevojave te komuniteteve te tyre. (Gjate gjithe vitit)
- Rritja dhe intensifikimi i punes dhe bashkepunimit me njesine e implementimit te projekteve per vazhdimin e organizimit te aktiviteve ne kuader te projektit DELMVET, per te mundesuar perfundimin me sukses te procesit mesimor 1 vjecar ne shkollen “Beqir Cela” ne klasat e 2 profileve me te nevojshme ne tregun e punes. (Janar – qershor)
- Perditessimi dhe mirembajtja e faqes web te projektit DELMVET, pasurimi i database me te dhena te tjera nga subjektet e AFP ne vend dhe nga Partneret e projektit. (Gjate tere vitit)
- Fillimi dhe implementimi sa me te suksesshem te Projektit “Enjoy your age”, “MED 3R”, CHALLENGES OF REGIONAL CENTERS: DEPOPULATION CONTROL, DEVELOPMENT – BEST PRACTICES. (qershor – dhjetor)
- Kerkimi dhe hartimi i projekteve te rinj ne ndihme te komunitetit te Qarkut, si ne kuader te programit IPA CROSS BORDER, ashtu edhe ne bashkepunim me organizata te tjera kombetare dhe nderkombetare. (gjate gjithe vitit)
- Pjesmarrje aktive ne seminar edhe trainime te organizuara ne nivel rajonal dhe nder rajonal. (gjate gjithe vitit)
- Implementimi dhe mbeshtetja e programit te kujdesit social duke parashikuar hartimin e programeve te kujdesit social ne nivel qarku per te gjitha shtresat dhe grupet ne nevoje. (gjate gjithe vitit)
- Vazhdimi i mbeshtetjes financiare te Shoqatave te ndryshme te Qarkut Durres, si Shoqata e te Verberve Durres - Kruje, Shoqata Ryder Albania, Shoqata e Invalideve te Punes Dega Durres, Komuniteti Rom, duke ofruar gjate 2015, sherbime te integruara per keto grupe sociale ne nevoje. (Shkurt – Maj)
- Pjesmarrje aktive ne pershtatjen dhe funksionimin sa me te suksesshem te ndarjes te re territoriale. (gjate gjithe vitit)

5. PROGRAMI I ADMINISTRATËS VENDORE

Qellimi i Programit

Ky program parashikon arritjen e nje performance te larte dhe mirefunksionimin e administratës te Keshillit te Qarkut, permes menaxhimit financiar dhe shpenzimeve te nevojshme administrative per vazhdimesine e veprimtarise se nje administrate profesionale, transparente, te hapur, te pergjegjeshme dhe bashkekohore.

Politika e Programit:

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Keshillit të Qarkut Durres, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese , garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Keshillit të Qarkut.

Për vitin 2016, ky program do të financohet në shumë/-*n 58,842 mije lekë.

Misioni i- programit të administratës vendore është

- harmonizimi politikave dhe shërbimeve rajonale të plota dhe cilësore për dhe qytetaret , në kuadër të parimit të “Qeverisjes së mire”, si dhe parimit “ Per qytetaret dhe në shërbim të qytetareve “
- të sigurojë dhe përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, të politikave të mandatuara në programin e miratuar nga Këshilli Qarkut.

Objektivat e politikës së programit:

- Rritjen, forcimin dhe kualifikimin e kapaciteteve të administratës së qarkut për të paraprirë ritmeve të zhvillimit ekonomik rajonal.
- Zbatimin e legjislacionit në fushën e etikës në shërbimin civil, të disiplinës dhe transparencës për të drejtën e informimit publik.
- Zbatimin me korrektesë të legjislacionit në fuqi “Per Statusin e Nepunesit Civil”
- Rritjen e pjesëmarrjes së punonjësve në periudhë prove në trajnime specifike për përmirësimin e efektivitetit të punës së tyre.
- Organizimi i trajnimeve me stafin e ri dhe atë ekzistues,
- Përmirësimi kushteve të punës për mbarevajtjen dhe rritjen e efikasitetit të punonjësve të administratës.
- Ruajtja e mirëadministrimit i vlerave materiale në dispozicion të administratës si dhe përmirësimi i nivelit higjieno-sanitar në mjediset e punës.

Produktet që synohet të ofrohen:

- Trajnime të niveleve të ndryshme sipas kërkesave të nepunesve dhe planit të trajnimeve në bashkëpunim me Universitetet publike dhe jopublike, institucione të specializuara për stafin e administratës së Keshillit Qarkut
- Lehtësimi i komunikimit të administratës me publikun përmes specialistit të Marrëdhënieve me Publikun ;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i ambienteve dhe kushteve të punës për shërbimin ndaj qytetarëve
- Mirembajtje të pajisjeve teknike ekzistuese ,dhe të ndërtesës.
- Vazhdimi i implementimit të programit të informatizimit të të gjithë aktivitetit të KQ Durres.
- Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetareve nga nepunesit e Keshillit të Qarkut dhe marrëdhënieve me të tretë;

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

- organizimi i aktiviteteve me natyre sociale per personelin e administrates.

Prioritet per vitin 2016

- Forcimi i kapaciteteve te administrates dhe e marredhenieve me publikun
- Rritja e cilësisë së shërbimeve për arritjen e një menaxhimi dhe perdorimin sa më efektiv të fondeve publike;
- Vendosja e kritereve sa me kualifikuese ne rekrutimin e stafit te ri te administrates.
- Bashkepunimi sa me efektiv ne nivel institucional e drejtorish .

Qëllimi i Programit:

Qëllimi i këtij programi konsiston në përmirësimin e mëtejshëm të funksionimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Durrës si dhe zhvillimit të kapaciteteve të tyre.

Objektiv i programit do të vazhdoj të jetë:

- Përqasja e funksionimit të administratës me politikat rajonale dhe ofrimi cilësor e i shpejtë i paketës së shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Trainimi i burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Durrës si për nëpunësit me status civil ashtu edhe për nëpunësit që janë në periudh prove.

Detajimi i fondeve sipas programit paraqitet sipas skemës së më poshtme.

Ne 000/leke

O1110	Programi i Administratës Vendore	Plani 2016
	Administrata e Këshillit Qarkut	
	Shpenzime personeli	
	Shpenzime operative	
	Këshilltarët	
	Fondi Rezervë	
	Fondi i Kontigjencës	
	Shpenzime Kapitale	
	Kuota anetaresimit AIE	
	Kuota anetaresimi AER	
	TOTALI	58.842

SEKTORI SHERBIME

Sofia Manasterliu

DREJTORIA E POLITIKAVE TEZHVILLIMIT TE QARKUT

JOVAN LIKJA

KESHILLI QARKUT DURRES – BUXHETI 2016

DREJTORI

ARDIT KERTUSHA

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT MBROJTJES TOKES

EMRUSH MAZARI

DREJTOR KABINETI

ARBEN ISAKU

KRYETAR I KESHILLIT QARKUT

ALFRED MULLARAJ

